



## Thirrje për Ekspertë dhe Kompani Konsulencë dhe Shërbimi për t'u Pjesë e Pool-it pranë People in Focus

People in Focus, një institucion i angazhuar në realizimin e aktiviteteve të zhvillimit dhe mbështetjes për komunitetet dhe individët, shpall hapjen e thirrjes për ekspertë dhe kompani për t'u bërë pjesë e pool-it të ekspertëve dhe kompanive.

Ky pool do të shërbejë për ofrimin e shërbimeve e konsulencave në realizimin e aktiviteteve të nevojshme për projekte të ndryshme, në përputhje me nevojat dhe kërkesat specifike të organizatës.

Pjesëmarrja në këtë pool nuk garanton një angazhim të menjëhershëm, por krijon mundësinë për bashkëpunim në përputhje me nevojat e projekteve që zbaton.

### Kategoritë e ekspertizave dhe shërbimeve të kërkuara :

- **Konsulencë Menaxhimi dhe Strategjie**
- **Konsulencë Ligjore dhe Politikë**
- **Zhvillimi i Projekteve dhe Monitorimi programatik dhe financiar**
- **Edukimi dhe Trajnimi në fushat e përcaktuara si: Mjedisi, Teknologjia & Inovacioni, Turizmi dhe Trashëgimia Kulturore, Bujqësia, Demokracia, Shteti i së Drejtës, Edukimi mediatik, Arsimit dhe Formimi Profesional (AFP)**
- **Financë dhe Menaxhim Financiar**
- **Komunikim dhe Marketing**
- **Studime dhe Hulumtime në fushat e përcaktuara si: Mjedisi, Teknologjia & Inovacioni, Turizmi dhe Trashëgimia Kulturore, Bujqësia, Demokracia, Shteti i së Drejtës, Edukimi mediatik, Arsimit dhe Formimi Profesional (AFP)**
- **Teknologji dhe Inovacion**
- **Mjedisi dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm**

**Vlefshmëria e Pool-it:** Ky pool do të shërbejë deri më datën **31/12/2026**, dhe mund të rinovohet sipas nevojave të organizatës.

### Kriteret për Kandidatët (Ekspertë dhe Kompani):

#### 1. Ekspertët/individë:

- **Arsimimi dhe Kualifikimet:** Kandidatët duhet të kenë një nivel të mjaftueshëm arsimi dhe kualifikimesh në fushat relevante për projektet. Kualifikimet profesionale shtesë dhe trajnimet janë vlerë e shtuar.
- **Eksperiencia Profesionale:** Ekspertët duhet të kenë të paktën **5 vite** eksperiencë në fushën përkatëse. Përvoja në projekte të financuara nga BE, veçanërisht në sektorin jofitimprurës ose në zhvillimin e qëndrueshëm.
- **Aftësitë e Komunikimit:** Kandidatët duhet të kenë aftësi të shkëlqyera komunikimi, si në formën e shkruar, ashtu dhe në atë verbale në gjuhën Shqip dhe Anglisht.

Str: Islam Alla, Njësia Administrative Nr.10,1001 Tiranë VAT L42011451D

Webpage: [www.peopleinfocus.org](http://www.peopleinfocus.org) / Email: [peopleinfocusalbania@gmail.com/info@peopleinfocus.org](mailto:peopleinfocusalbania@gmail.com/info@peopleinfocus.org)

Tel: +35542224927



- **Aftësitë Analitike dhe Kritike:** Ekspertët duhet të jenë të aftë të analizojnë dhe të vlerësojnë situata komplekse, të zhvillojnë strategji të efektshme dhe të ofrojnë rekomandime praktike.
- **Angazhimi për Zhvillimin të qëndrueshëm:** Kandidatët duhet të kenë një angazhim të fortë për zhvillimin e qëndrueshëm dhe përfshirjen sociale.
- **Aplikimet duhet të përmbajnë:** Curriculum Vitae dhe Letër motivimi

## 2. Kompanitë:

- **Licenca dhe Regjistrimi:** Kompanitë duhet të jenë të regjistruara sipas legjislacionit shqiptar. Licenca përkatëse për ofrimin e shërbimeve në fushat përkatëse të ekspertizës janë përparësi
- **Eksperienca të Mëparshme:** Kompanitë duhet të kenë të paktën **3 vite** eksperiencë në realizimin e shërbimeve të ngjashme, veçanërisht në sektorët e menaxhimit të projekteve të BE, konsulencës, trajnimit dhe zhvillimit të kapaciteteve.
- **Kualifikimi i stafit dhe Burimet:** Kompanitë duhet të kenë staf të kualifikuar dhe burime të mjaftueshme për të ofruar shërbime të cilësisë së lartë.
- **Cilësia e Shërbimeve:** Kompanitë duhet të jenë të angazhuara në ofrimin e shërbimeve me standarde të larta cilësore dhe duhet të jenë të gatshme të ndjekin procedurat dhe rregullat e organizatës.
- **Aplikimet duhet të përmbajnë:** Ekstraktin e regjistrimit dhe Profilin e Kompanisë përfshirë eksperiencat e mëparshme

Aplikimet mund të dërgohen në adresën [info@peopleinfocus.org](mailto:info@peopleinfocus.org) me subjekt: Aplikim për pool-in e ekspertëve dhe kompanive pranë People in Focus

- Afati i dorëzimit të aplikimeve është deri në datën **3 Mars 2025**.

Ftojme ekspertë dhe kompani që përmbushin kërkesat të aplikojnë për tu bërë pjesë e këtij pool-i.

Aplikimi i suksesshëm nuk përben detyrim kontraktual midis People in Focus dhe ekspertëve/ kompanive të përzgjedhura. Vetëm individët dhe subjektet e përzgjedhur do të kontaktohen.

**People in Focus** ju falenderon për interesimin dhe angazhimin tuaj!

**Data e shpalljes: 17 Shkurt 2025**